



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë publikon:

NJOFTIM

Njoftohen kandidatët të cilët kanë dhënë betimin për ekspert gjyqësor sipas listës së publikuar nga Komisioni Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve të kandidatëve për Licencim për Ekspert Gjyqësor, që të sjellin dëshmitë që i kanë plotësuar kushtet e parapara sipas nenit 19 të Ligjit nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësor;

1. Pas dhënies së betimit, subjekti që kryen ekspertizë:

1.1. Lidhë marrëveshje për sigurimin e dëmit;

1.2. Duhet të ketë vulën zyrtare (Në bazë të Ligjit NR. 03/L-054 Për vula në institucionet e Republikës së Kosovës); dhe

1.3. Duhet të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet e tij në Ministri.

Dëshmitë sipas pikës 1 të këtij njoftimi dorëzohen në Ministrinë e Drejtësisë, ish-ndërtesa "Rilindja", kati përdhese, Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë 10 000, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16:00.